

DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË
LIDHEN ME AGJENCINË
KOSOVARE TË
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF KOSOVO
ON KOSOVO TRUST AGENCY
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODNOSE NA
KOSOVSKU
POVERENIČKU AGENCIJU

ASC-09-0072

Në padinë e

[REDACTED]

Paditësi/Ankuesi

Matiqan - Prishtinë,

i përfaqësuar nga [REDACTED] avokat në Prishtinë

kundër

[REDACTED] NP

E Paditura

Ish rr. [REDACTED]

tani rr. [REDACTED] Prishtinë

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posacme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS) i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, në ankesën e Paditësit kundër aktvendimit të DHPGJS-së të datës 15 tetor 2009, SCC-09-0090, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 29 prill 2010, lëshon këtë:

AKTVENDIM

Ankesa është e bazuar.

Aktvendimi i DHPGJS-së i datës 15 tetor 2009, SCC-09-0090, hedhet poshtë.

Trupi Gjykues urdhërohet të rigjykojë padinë.

Obligohet e Paditura të paguaj taksat dhe shpenzimet gjyqësore në vlerë prej 60,-- eurosh për procedurën ankimore në Dhomën e Posacme.

Trupi Gjykues do të duhet të vendos për shumën e shpenzimeve në procedurën e shkallës së parë dhe ndarjen e tyre ndërmjet palëve, si dhe ndarjen e shpenzimeve të procedurës ankimore.

Arsyet Ligjore:

Në padinë e tij të 15 majit 2009, Paditësi kërkon vërtetimin e të drejtave pronësore mbi ngastrën e caktuar të tokës, e fituar dhe poseduar nga babai i tij, e cila (për shkak të arsyeve të panjohura) është regjistruar në librat kadastrale në emër të Paditurës. Autorizimi i datës 7 maj 2009, përfshirë përkthimin e tij në anglisht është dorëzuar së bashku me padinë dhe dokumenteve tjera.

Me urdhrin e datës së 10 gushtit 2009, Trupi Gjyques kërkoi nga Paditësi të dorëzojë brenda 14 ditëve 1.) adresën për dërgim të Paditurës, 2.) "të gjitha faktet materiale që i përmban padia, argumentet ligjore mbi të cilat bazohet padia dhe listën e dëshmive të cilat Paditësi ka për qëllim t'i paraqesë me përkthim në anglisht", 3.) "autorizimin i cili i jep autoritet avokatit i cili e ka nënshkruar padinë për të përfaqësuar Paditësin në procedurën para Dhomës së Posaçme me përkthimin e tij në anglisht (autorizimi i bashkëngjitur në padi e autorizon avokatin vetëm të përfaqësojë Padinë në Gjykatën Komunale në Prishtinë)", dhe 4.) "dëshminë se Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit i është dorëzuar njoftim me shkrim për qëllimin e ushtrimit të padisë në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12, me përkthim në gjuhën angleze"; në të thuhej se në rast të mos "dorëzimit të dokumenteve të kërkua të lartë brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve nga njoftimi i dërgimit të urdhrit, Dhoma e Posaçme e refuzon padinë mbi baza të papranueshmërisë."

Brenda afatit të dhënë (më 4 shtator 2009), Paditësi e dorëzoi edhe një autorizim në gjuhën shqipe, dhe kopjen e "njoftimit për ushtrimin e padisë" të datës 6 korrik 2009, në gjuhën shqipe dhe angleze. Për më tepër, ai e dha një adresë të Paditurës, duke thënë se kjo adresë ishte e njohur publikisht; veç kësaj, ai iu referua argumenteve ligjore dhe dëshmive të paraqitura në padi, dhe pohoi se autorizimi e ka përfshirë edhe përfaqësimin e tij para Dhomës së Posaçme. Së fundi u paraqiten emrat e dëshmitarëve (tjerë).

Me aktvendimin e sfiduar të 15 tetorit 2009, Trupi Gjyques i Dhomës së Posaçme e refuzoi padinë si të papranueshme. Në arsyetimin ligjor, aktvendimi i referohet urdhrit të 10 gushtit 2009. Madje në bazë të atij urdhri, Paditësi "nuk ka arritur të dorëzojë informatat sipas kërkesave të nenit 27.2 të UA-së së UNMIK-ut

2008/6. Në veçanti, Paditësi nuk e ka dorëzuar përkthimin e autorizimit në gjuhën angleze, për më tepër dokumenti i dorëzuar nga Paditësi tregon se njoftimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është bërë shumë vonë, përkatësisht pas dorëzimit të padisë, përderisa në bazë të ligjit duhet të bëhet 60 ditë para ushtrimit të padisë në Dhomën e Posaçme". Prandaj, padia duhej të refuzohej si e papranueshme, konkludoi Trupi Gjykues.

Në ankesën e ushtruar me kohë nga Paditësi, Kolegjitet e Ankesave të Dhomës së Posaçme i kërkohej të hedhë poshtë aktvendimin e apeluar dhe të kthejë lëndën për rigjykim në shkallën e parë.

Ankesa është e bazuar.

Ankuesi pohon se me përgjigjen e tij të datës 14 shtator 2009, urdhri i Trupit Gjykues i datës 10 gusht 2009 është përmbushur plotësisht. Ai në veçanti thekson se të gjitha faktet relevante ishin dhënë dhe dëshmia ishte paraqitur, se adresa e të Paditurës ishte shumë njohur në Prishtinë, dhe se nuk kishte arsy (tjetër) për të përkthyer autorizimin. Megjithëse, përkthimi në anglisht i autorizimit të datës 7 maj 2009, pasi që veç ishte dorëzuar me padinë, është bashkëngjitur përsëri (së bashku me një përkthim tjetër në anglisht).

Argumentimi i Ankuesit është i drejtë:

Adresa e të Paditurës:

Neni 27.2 (c) i UA-së së UNMIK-ut 2008/6 parashevë deklarimin e adresës për dërgim të Paditurit në padi. Në bazë të nenit 28.2 (f) të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, në lidhje me nenin 28.4 leg cit, mos paraqitja e adresës do të rezultojë në një urdhër për plotësim apo përmirësim të padisë brenda periudhës së caktuar, dhe refuzimi i padisë si e papranueshme bëhet nëse urdhri nuk përmbushet me kohë.

Në padinë në fjalë, kjo adresë ishte paraqitur me kohë në bazë të urdhrit të Trupit Gjykues. Prandaj, çështja e adresës më nuk ishte problem sa i përket pranueshmërisë së padisë. Duhet të shënohet në atë rast, se nëse Paditësi pohon se adresa e të Paditurës është e njohur mirë, pa e paraqitur atë, do të ishte e

këshillueshme që të kërkonte adresë (siç është bërë këtu nga Trupi Gjyques); megjithatë, refuzimi (përfundimtar) i padisë si e papranueshme do të kërkonte dështimin e dërgimit në atë adresë të Paditurës. Apo, për të thënë mënyrë tjetër: padia mund të hedhet poshtë si e papranueshme vetëm mbi bazat e nenit 27.2 (c) të UA-së 2008/6, nëse Paditësi nuk e paraqet fare adresën sipas kërkesës, ose nëse dështon dërgimi në atë adresë e cila pohohet si e njohur.

Autorizimi:

(Përkthimi në anglisht i) autorizimi(t), siç parashihet në nenin 24.6 në lidhje me nenet 25, 28.3 (f) dhe 28.4 të UA-së 2008/6, është gjithashtu ndër kriteret e pranueshmërisë së padisë.

Në rastin në fjalë, përkthimi në anglisht i autorizimit të 7 majit 2009, i dorëzuar së bashku me padinë, thotë: "... *Unë jap këtë autorizim për ... të përfaqësojë ... çështjet juridiko-civile ... dhe administrative në gjykatat kompetente, ... autoritetet e UNMIK-ut dhe AKM dhe në organet tjera të cilat do të zhvillohen në Gjykatën Komunale në Prishtinë ... Unë e jap këtë autorizim për ... të më përfaqësojë në çështjet juridike para UNMIK-ut, gjykatave dhe organizatave tjera për të realizuar të drejtat e mia*"

Në kundërshtim me pozicionin e Trupit Gjyques siç është formuluar në aktvendimin e atakuar, dhe urdhrit të tyre të datës 10 gusht 2009, ky autorizim nuk është i kufizuar që ta përfaqësojë Ankuesin para Gjykatës Komunale të Prishtinës. Prandaj, arsyja e dhënë nga Trupi Gjyques për refuzimin e padisë mbi këto baza nuk është i vlefshëm.

Faktet dhe argumentet ligjore, lista e dëshmive (neni 27.2 [e] i UA-së 2008/6):

Neni 28.2 (f) paraqet ndër kriteret e pranueshmërisë së padisë (të gjitha) "... kërkesat e neneve 25 dhe 27 ...", në vështrim të parë duke lënë përshtypjen se të gjitha elementet e radhitura aty mund të shpien në hedhjen poshtë të padisë si të papranueshme, nëse nuk paraqiten në bazë të urdhrit (shih nenin 28.4 të UA-së 2008/6). Një reflektim më i afërt, megjithatë, nxjerr në sheh se fushëveprimi i kësaj dispozite duhet të reduktohet mbi baza teleologjike:

Në mënyrë të qartë, një nga parimet kryesore të përgjithshme të Kodeve Civile Procedurale të Evropës kontinentale është përbillyja e padisë (pasi që çështja nëse faktet e pretenduara, në lidhje me argumentet ligjore të prezantuara mund të ketë pasoja ligjore sipas kërkesës në padi) duke mos qenë problem çështja e pranueshmërisë së padisë, por e meritave të saj. Nëse nuk prezantohen fakte (të mjaftueshme) dhe/ose argumente ligjore, apo nëse faktet e pohuara nuk shpien në konkludim sipas asaj që është paraqitur nga Paditësi, padia mund vetëm të refuzohet si e pabazë, nëse nuk sqarohet sipas kërkesës.

E njëjtë vlen për listën e dëshmive: Në parim, vetëm faktet e kontestuara duhet të vërtetohen nga Paditësi. Nëse e Paditura nuk i konteston faktet siç pohohen në padinë përfundimtare, nuk ka nevojë të merren dëshmi. Lista e dëshmive mund të hyjë në përdorim vetëm nëse grumbullimi i dëshmive është i nevojshëm. Para së gjithash, padia mund të refuzohet si e pabazë, nëse Paditësi nuk arrin të dorëzojë dëshmi për të vërtetuar faktet të cilat i ka kontestuar e Paditura. Para përfshirjes së Paditurës, lista e dëshmive mund të kërkohet, nëse Paditësi duhet të sqarojë çështje tjera, megjithatë, por kjo nuk mund të jetë çështje në atë fazë të procedurës. Për më tepër, lista e cila mungon nuk mund të shpie asnjëherë në hedhjen poshtë të padisë.

Në lëndën në fjalë, e Paditura ende nuk ka qenë e përfshirë. Prandaj, faktet materiale, lista e dëshmive, argumentet ligjore, ende nuk janë çështje relevante. Përveç kësaj, nuk mund të shihet deri në çfarë mase Trupi Gjykues e konsideron si të pamjaftueshme padinë: Faktet dhe argumentet ligjore janë dhënë (pronësia e pretenduar mbi një ngastër të caktuar të tokës, regjistrimin në emër të Paditurës pa i ditur arsyet) së bashku me dëshminë për shfrytëzim (emrat e dëshmitarëve). Lidhja e cila mungon në mes të blerjes së pretenduar të babait të Paditësit dhe pronësisë së pretenduar të Paditësit (si çështje e trashëgimisë ligjore) është çështje e përbillyjes së padisë. Trupi Gjykues nuk ka kërkuar sqarim në lidhje me këtë çështje; si është thënë më lartë, mund të shpie në refuzimin e padisë në një fazë të mëvonshme, nëse kjo nuk sqarohet.

Si pasojë, arsyetimi ligjor i Trupit Gjykues në lidhje me faktet, dëshmitë dhe argumentet ligjore nuk mund të mbështetet.

Njoftimi i Agjencisë (neni 28.2 [e] i UA-së 2008/6):

Në bazë të nenit 29.1 të RREG të UNMIK-ut 2002/12 (në lidhje me nenin 28.2 [e] të UA-së 2008/6), njoftimi me shkrim i qëllimit për të ushtruar padi kundër një NSH-je duhet t'i bëhet Agjencisë para dorëzimit të padisë (referimi i Trupit Gjyques për 60 ditët e njoftimit sipas parashikimit në nenin 30.2 të RREG të UNMIK-ut 2002/12 është i pasaktë, pasi që kjo dispozitë aplikohet vetëm për paditë kundër Agjencisë). Gjithashtu, njoftimi i Agjencisë për qëllimin për të ushtruar padi është ndër kriteret e pranueshmërisë sipas përcaktimit në nenin 28.3 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6. Megjithëse kriteret e pranueshmërisë duhet të shqyrtohen ex officio, në atë fazë të hershme të procedurës (ende pa u përfshirë e Paditura) pohimi i vetëm i Paditësit se është bërë njoftimi i duhur – në parim – është i mjaftueshëm, duke e ndjekur mostrën e njëjtë të përshkruar më lartë. Nëse Paditësi pohon (në padi apo në bazë të urdhrit në pajtim me 28.4 të UA-së 2008/6) se është parashtruar njoftimi i duhur, Trupi Gjyques nuk mund të hedhë poshtë padinë si të papranueshme nga kjo arsy. Përderisa padita të mos jetë e papranueshme mbi bazat tjera, duhet t'i jepet mundësia të Paditurës të merr qëndrim për njoftimin (e pretenduar), së bashku me meritat e lëndës (duke ia dërguar padinë dhe dokumentet tjera të Paditurës; *audiatur et altera pars*). Pastaj i mbetet të Paditurës të kontestojë faktet që gjenden në padi, përfshirë njoftimin (e pasafatshëm) të pretenduar. Vetëm nëse e Paditura (në mënyrë potenciale e përfaqësuar nga Agjencia) e konteston njoftimin (e pasafatshëm), do t'i kërkohet Paditësit të vërtetojë njoftimin.

Në lëndën në fjalë, e Paditura nuk e ka pasur ende mundësinë të kontestojë njoftimin. Paditësi e ka dorëzuar një kopje të njoftimit të datës 6 korrik 2009, por, qartë tregon se është ushtruar pas dorëzimit të padisë (15 maj 2009), dhe prandaj nuk është në pajtim me nenin 29.1 të RREG të UNMIK-ut 2002/12 në lidhje me nenin 28.2 (e) të UA-së së UNMIK-ut 2008/6. Në këto rrethana, nuk ka pasur nevojë të përfshihet e Paditura; pas parashtresës së Paditësit të datës 4 shtator 2009, veç ishte e qartë se jo të gjitha kriteret e pranueshmërisë janë plotësuar në datën e ushtrimit të padisë.

Megjithatë, duhet të merret parasysh këtu se nga 6 korrik 2009, AKP-ja ka pasur njohuri për padinë. Që nga atëherë, ata nuk kanë zgjedhur që të hyjnë në procedurë si përfaqësues të Paditurës. Duke e mbajtur në mend se qëllimi i

njoftimit është të njoftohet Agjencia në lidhje me padi (potenciale), dhe t'i u ofrohet atyre mundësia që të merr përgjegjësinë në emër të NSH-së, synimi i njoftimit është përbushur (në të njëjtën kohë). Për më tepër, është marrë parasysh se detyra e Paditësit për të njoftuar paraprakisht agjencinë e shton barrën për të sa i përket qasjes në drejtësi, dhe prandaj duhet të interpretohet në mënyrë kufizuese. Në rrethana specifike të lëndës, do të mund të konsiderohej si shkelje e të drejtës ligjore, nëse (AKP-ja në emër të saj) e Paditura tani do t'i referohej si njoftim i pasafatshëm. Në këtë situatë të veçantë, Kolegji i Ankesave e konsideron njoftimin e pasafatshëm pa pasojë (të mëtejme) në gjykimin e padisë.

Prandaj, hedhja poshtë e padisë si e papranueshme nuk ka qenë e duhur. Aktvendimi i atakuar, prandaj, nuk mund të qëndrojë dhe duhet të revokohet. Trupi Gjykues do të duhet që të merret (përsëri) me padinë, duke u përbajtur nga hedhja poshtë e mëtejme mbi bazat e njëjtë.

Gjatë rigjykimit të padisë, Trupi Gjykues mund ta mendoj të nevojshme (më vonë) të sqarojë çështjen e përmendur më lartë të trashëgimisë ligjore nga ana e Paditësit, dhe fakti që kontrata e shitjes e paraqitur nuk ka të bëjë as me ngastrën e tokës në kontest, dhe as me ndonjëren nga palët e lëndës.

Taksat/shpenzimet gjyqësore:

Sipas nenit 11 të RREG 2008/4 dhe nenit 66 të UA 2008/6, Trupi Gjykues merr vendim lidhur me shpenzimet e bëra gjatë procedurës gjyqësore në shkallën e parë dhe Kolegji i Ankesave – kur vendos për një lëndë përfundimisht – lidhur me shpenzimet e bëra gjatë procedurave gjyqësore në të dyja shkallët. Lënda në fjalë duhet të rigjykohet në shkallën e parë; prandaj, nuk mund të merret vendim mbi caktimin e shpenzimeve të bëra tani për tani, pasi që ky caktim varet nga vendimi i ardhshëm i Trupit Gjykues. Tani për tani, mund të caktohet vetëm shuma e taksave gjyqësore në shkallën e dytë:

Në bazë të nenit 57.2 të UA UNMIK-ut 2008/6 Dhoma e Posaqme ka nxjerrë Rregullat Plotësuese Procedurale lidhur me Taksat Gjyqësore, që janë në fuqi që nga data 10 mars 2010.

Aty thuhet si vijon:

'Neni 10 i Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/2 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 27.11.2008, lidhur me "Tarifat e Taksave Gjyqësore" – me specifikimet e mëposhtme – shpallet të jetë i aplikueshëm për procedurat gjyqësore para DHPGJS-së.

Neni 10.9 deri te neni 10.23 janë të aplikueshëm – mutatis mutandis – për procedurën ankimore para Trupit Gjykues dhe para Kolegjit të Ankesave.

Si sqarim, neni 10.11 është i aplikueshëm edhe për procedurën që drejton ankimin kundër aktvendimeve të shkallës së dytë të Trupit Gjykues.

(...)

Këto Rregulla Plotësuese Procedurale kanë hyrë në fuqi më 10 mars 2010 dhe vlejnë deri më 31 dhjetor 2010.'

Taksat gjyqësore në të dyja shkallët përbëhen, në njérën anë nga një taksë për ushtrimin e parashtresës(ave), në anën tjetër nga një taksë për lëshimin e (një) aktvendimi(eve).

Sic u tha me lartë, do t'i mbetet Trupit Gjykues të vendosë për vlerën e taksave gjyqësore në shkallën e parë, që përbehet nga dy komponente dhe caktimi i tyre.

Sa i përket procedurës ankimore:

Shuma e taksës për ushtrimin e ankesës sic rregullohet me nenin 10.11 të Urdhëresës Administrative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Nr. 2008/2 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore ("ADJ") është 30,-- Euro.

Neni 10.15 ADJ përcakton se për aktvendimet për hedhjen e padive (si të papranueshme) duhet të paguhet vetëm gjysma e taksës të rregulluar në nenin 10.1 ADJ (që parimisht i bazon taksat gjyqësore në vlerën e padisë), deri në shumën maksimale prej 30,-- Euro. Kjo vlen edhe për aktvendimet në shkallën e dytë (neni 10.21 ADJ i referohet neneve 10.12 deri 10.18 ADJ). Neni 10.15 në lidhje me nenin 10.21 përfshin aktvendimet në shkallën e dytë që hedhin poshtë

IX

ankesat si të papranueshme, si dhe aktvendimet mbi ankesat kundër aktvendimeve të shkallës së parë që nuk i prekin meritat e lëndës.

Përveç kur vlera e padisë dëshmohet të jetë më e vogël (në shkallën e parë nga paditësi, në shkallën e dytë nga ankuesi), sipas nenit 10.1 në lidhje me nenet 10.15 dhe 10.21, taksa gjyqësore është 30,-- Euro.

Në lëndën në fjalë, as në shkallën e parë e as në shkallën e dytë nuk janë bërë deklarimet për vlerën e padisë. Prandaj, taksa gjyqësore për aktvendimin në shkallën e dytë është përcaktuar 30,-- Euro.

Në përgjithësi, për procedurat e ankimeve vlejnë taksat gjyqësore në vijim:

Tarifat e taksave gjyqësore, neni 10.11 (ushtrimi i ankesës)	30 Euro
Tarifat e taksave gjyqësore, neni 10.15 lidhur me 10.21 dhe 10.1 (aktvendimi në shkallën e dytë)	30 Euro
Gjithsej	60 Euro

Këto taksa gjyqësore do të barten paraprakisht nga Ankuesi, i cili është i obliguar të paguaj shumën e përmendur në Dhomën e Posaçme (shih nenin 2 [1] të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës të 3 tetorit 1987).

Do ti mbetet Trupit Gjykues që tua caktojë palëve këto shpenzime të procedurës ankimore, së bashku me aktvendimin e shkallës së parë, përfshirë edhe vendimin mbi shpenzimet (e ardhshme) të shkallës së parë.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it [nënshkruar]

Torsten Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it [nënshkruar]

Eija -Liisa Helin, Gjyqtare e EULEX-it [nënshkruar]

Tobias Lapke, Regjistrues i EULEX-it [nënshkruar]